




REPUBLICA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORATI



Nr. 2306 / Prot.

Vlorë më, 16.12.2024

VENDIM

Nr. 24, datë 12.12.2024

**PËR
MIRATIMIN E REKOMANDIMEVE, MBËSHTETUR NË REZULTATET E
PYETËSORIT TË STUDENTËVE PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË
MËSIMDHËNIES NË LËNDËT E ÇDO PROGRAM STUDIMI PËR VITIN
AKADEMIK 2023-2024**

Në mbështetje nenit 40 të Ligjit 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 26, të Statutit të UV-së, referuar shkresës nr. 2408/1, prot, datë, 05.12.2024, Rektorati në mbledhjen e datës, 12.12.2024,

VENDOSI:

1. Të miratojë Rekomandimet mbështetur në Rezultatet e Pyetësorit të Studentëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies në lëndët e çdo program studimi për Vitin Akademik 2023-2024 sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Njësitë Kryesore, Njësitë Bazë, Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm Cilësisë dhe Projekteve dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse në UV.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

PROF. DR. AURELA SALIAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
KOMISION AD-HOC



Nr. 2408/Prot.

Vlorë më, 05.12.2024

Lënda: Raport mbi hartimin e rekomandimeve mbështetur në rezultatet e pyetësorit të studentëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies në lëndët e çdo program studimi për vitin akademik 2023-2024.

REKTORIT TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI"

PROF. DR. AURELA SALIAJ

KËTU

Në përgjigje të Urdhërit Nr. 180 datë 24.10.2024 me Nr. 2408 Prot. Datë 24/10/2024, "Për Ngritjen e grupit të punës mbi hartimin e rekomandimeve mbështetur në rezultatet e pyetësorit të studentëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies në lëndët e çdo program studimi për vitin akademik 2023-2024, Ju lutem gjeni bashkëlidhur rekomandimet e hartuara nga grupi i punës.

Në bazë të rezultateve, në të 4 Fakultetet mund të konkludojmë se:

1. Pjesëmarrja në plotësimin e pyetësorit në nivel universiteti është rreth 82.6%;
 - Fakulteti i Shkencave Humane – 74.2%
 - Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore – 77.7%
 - Fakulteti i Ekonomisë – 82.2%
 - Fakulteti i Shëndetit – 96.4%
2. Në një nivel rreth 93% studentët raportojnë se ishin "plotësisht dakort" dhe "dakort" se "Leksionet ishin të strukturuar dhe organizuara mirë";
3. Në një nivel të lart studentët raportojnë se materialet e leksioneve ishin të qarta dhe përmirësuan të nxënin (92.8% "plotësisht dakort" dhe "dakort");
4. Në një nivel mbi 90% studentët raportojnë se pedagogët transmetonin idetë dhe konceptet në mënyrë të qartë;

Adresa /Address: Blv. Ismail Qemali, Pallatet Conad, kati II, Vlorë, Albania, 9400
Tel. Fax ++35533224952

web-site: www.univlori.edu.al
e-mail: info@univlori.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRIË
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
KOMISION AD-HOC



5. Në një nivel mbi 90% studentët raportojnë se janë plotësisht dakord / dakord se pedagogët nxisin dialogun/diskutimin në auditor si dhe nxisin mendimin kritik duke bërë lëndën interesante;
6. Studentët raportojnë se në përqindje shumë të lart (92.3%) se pedagogët japin sqarime dhe janë të gatshëm vazhdimisht të ndihmojnë studentët në raste që ata kanë pyetje/paqartësi;
7. Njohja me syllabysin e çdo lënde në fillim të semestrit akademik është raportuar si plotësisht dakort / dakort prej 91.8% e studentëve pjesmarës në anketime;
8. Raportimi se “Në përfundim të çdo lënde/moduli pedagogu vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe na orienton mbi zbatimin e tyre” mbështetet prej një numri të konsiderueshëm studentësh (mbi 90%);
9. Në një nivel të lart studentët raportojnë se pedagogët krijojnë klimë të përshtatshme në zhvillimin e ideve të reja nisur nga studimet e ndryshme kërkimore-shkencore dhe se i mbështesin ata në zhvillimin e ideve të reja (mbi 90%);
10. Në një nivel më të lart se 88% studentët raportojnë se janë plotësisht dakord/dakord se pedagogët kanë qenë objektiv dhe të drejtë në korrigjimin dhe vlerësimin e njohurive.
11. Studentët në nivel mbi 90% janë të kënaqur me eksperiencën e tyre në modulet e zhvilluara në programet respektive.

Si pika kryesore të forta

Nga të gjitha fakultetet, disa aspekte janë vlerësuar shumë pozitivisht nga studentët, duke përfshirë:

- *Cilësia e pedagogëve*: Përkushtimi dhe gatishmëria e tyre për të ndihmuar studentët.
- *Struktura dhe qartësia e leksioneve*: Veçanërisht në programet Bachelor.
- *Komponentët praktikë*: Në degë si infermiera dhe turizmi, praktikat janë konsideruar mjaft të dobishme.

Propozime për përmirësim të situatës në bazë të pyetjeve kualitative dhe kuantitative:

1. Përmirësimi i Mësimdhënies dhe Metodave Didaktike

- *Struktura e leksioneve dhe seminareve*: Nevojitet balancim dhe organizim më i mirë për të krijuar dije të qëndrueshme dhe të integruara ndërmjet teorisë dhe praktikës.

Adresa / Adresy: Blv. Ismail Qemali, Pallatet Conad, kati II, Vlorë, Albania, 9400
Tel. Fax ++35533224952

web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
KOMISION AD-HOC

5. Në një nivel mbi 90% studentët raportojnë se janë plotësisht dakord / dakord se pedagogët nxisin dialogun/diskutimin në auditor si dhe nxisin mendimin kritik duke bërë lëndën interesante;
6. Studentët raportojnë se në përqindje shumë të lart (92.3%) se pedagogët japin sqarime dhe janë të gatshëm vazhdimisht të ndihmojnë studentët në raste që ata kanë pyetje/paqartësi;
7. Njohja me syllabysin e çdo lënde në fillim të semestrit akademik është raportuar si plotësisht dakort / dakort prej 91.8% e studentëve pjesmarës në anketime;
8. Raportimi se "Në përfundim të çdo lënde/moduli pedagogu vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe na orienton mbi zbatimin e tyre" mbështetet prej një numri të konsiderueshëm studentësh (mbi 90%);
9. Në një nivel të lart studentët raportojnë se pedagogët krijojnë klimë të përshtatshme në zhvillimin e ideve të reja nisur nga studimet e ndryshme kërkimore-shkencore dhe se i mbështesin ata në zhvillimin e ideve të reja (mbi 90%);
10. Në një nivel më të lart se 88% studentët raportojnë se janë plotësisht dakord/dakord se pedagogët kanë qenë objektiv dhe të drejtë në korrigjimin dhe vlerësimin e njohurive.
11. Studentët në nivel mbi 90% janë të kënaqur me eksperiencën e tyre në modulet e zhvilluara në programet respektive.

Si pika kryesore të forta


Nga të gjitha fakultetet, disa aspekte janë vlerësuar shumë pozitivisht nga studentët, duke përfshirë:

- *Cilësia e pedagogëve:* Përkushtimi dhe gatishmëria e tyre për të ndihmuar studentët.
- *Struktura dhe qartësia e leksioneve:* Veçanërisht në programet Bachelor.
- *Komponentët praktikë:* Në degë si infermiera dhe turizmi, praktikat janë konsideruar mjaft të dobishme.

Propozime për përmirësim të situatës në bazë të pyetjeve kualitative dhe kuantitative:

1. Përmirësimi i Mësimdhënies dhe Metodave Didaktike

- *Struktura e leksioneve dhe seminareve:* Nevojitet balancim dhe organizim më i mirë për të krijuar dije të qëndrueshme dhe të integruara ndërmjet teorisë dhe praktikës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
KOMISION AD-HOC

- *Metoda të reja mësimore:* Përdorimi i metodave interaktive si projekte grupore, "learning by doing," dhe diskutime që promovojnë mendimin kritik.
- *Praktika dhe raste studimore:* Përfshirja e rasteve reale dhe skenarëve praktikë në leksione për t'i afruar studentët me situata të jetës reale.

2. Teknologjia dhe Infrastruktura

- *Pajisje moderne:* Përmirësimi i laboratorëve me teknologji të avancuar, përfshirë simulorë dhe pajisje 3D për lëndë si anatomia dhe infermiera.
- *Platforma digjitale:* Përdorimi i platformave si Google Classroom për shpërndarjen e materialeve dhe për komunikim më efektiv.
- *Akses në burime:* Sigurimi i literaturës bashkëkohore dhe rritja e mundësive për shkëmbime ndërkombëtare me universitete të tjera.

3. Praktikat dhe Trajnimet

- *Rritja e orëve praktike:* Veçanërisht për programet me orientim profesional, si infermiera dhe turizmi, për të ndihmuar studentët në aplikimin e njohurive teorike.
- *Laboratorë të avancuar:* Zgjerimi i kapaciteteve laboratorike për fusha si kirurgjia dhe patologjia.
- *Përfshirja në praktikë reale:* Bashkëpunimi me spitale, shkolla dhe operatorë turistikë për përvojë më të gjerë praktike.

4. Feedback dhe Vlerësimi


- *Transparenca:* Sigurimi i udhëzimeve të qarta për provimet dhe vlerësimet. Pedagogët duhet të ofrojnë feedback të detajuar dhe në kohë.
- *Vlerësimi objektiv:* Vlerësimi i studentëve duhet të jetë i drejtë dhe i bazuar në kritere të qarta për të reduktuar pasigurinë.

5. Mbështetja për Studentët dhe Pedagogët

- *Trajnimi i stafit:* Trajnime për përdorimin e teknologjive dhe metodologjive të reja mësimore.
- *Angazhimi i pedagogëve:* Pedagogët duhet të jenë më të pranishëm për të ndihmuar studentët me udhëzime teknike dhe akademike.
- *Dialog dhe diskutime:* Nxitja e komunikimit të hapur ndërmjet studentëve dhe pedagogëve për çështje komplekse dhe sfida mësimore.

Adresa /Address: Biv. Ismail Qemali, Pallatet Conad, kati II, Vlorë, Albania, 9400
Tel. Fax 4+35533224952

web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
KOMISION AD-HOC

6. Pjesmarrja më e madhe e studentëve

- *Angazhimi aktiv i studentëve në leksione, seminare, praktika dhe laboratore: Trajnime për përdorimin e teknologjive dhe metodologjive të reja mësimore.*
- *Anketim më i madh i studentëve në plotësimin e anketimeve për të siguruar një feedback më të plotë në lidhje me cilësinë e programeve të ofruara.*
- *Përfshirja e studentëve në grupe pune në projekte kërkimore dhe aktivitete të cilat rrisin ndërgjegjësimin e tyre për profesionin.*

Adresa /address: Blv. Ismail Qemali, Pallatet Conad, kati II, Vlorë, Albania, 9400
Tel. Fax: ++35533224952

web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
KOMISION AD-HOC

Plan veprimi:

Objektivi specifik	Aktiviteti	Strukturat përgjegjëse	Burimet
<i>Struktura e leksioneve dhe seminareve</i>	Nevojitet balancim dhe organizim më i mirë për të krijuar dije të qëndrueshme dhe të integruara ndërmjet teorisë dhe praktikës. Parashikimi në buxhet i fondeve specifike për literaturë bashkëkohore; Përdorim më i lartë prej pedagogëve dhe studentëve të bibliotekave on-line.	Njësitë bazë	Burimet njerëzore
<i>Metoda të reja mësimore</i>	Përdorimi i metodave interaktive si projekte grupore, "learning by doing," dhe diskutime që promovojnë mendimin kritik. Trajnim i pedagogëve për mësimdhënie inovative; Zhvillimi i mësimin në mënyrë interaktive; Përfshirja në mësimdhënie e stakeholders-ave me të cilët universiteti bashkëpunon Parashikimi në buxhet për përmirësimin e bazës materiale	Senati akademik Bordi i Administrimit Njësitë Kryesore Njësitë Bazë	Burime njerëzore Burime financiare
<i>Praktika dhe raste studimore</i>	Përfshirja e rasteve reale dhe skenarëve praktikë në leksione për t'i afruar studentët me situata të jetës reale	Njësitë bazë	Burimet njerëzore
<i>Pajisje modern në laboratore</i>	Përmirësimi i laboratorëve me teknologji të avancuar, përfshirë simulatorë dhe pajisje 3D. Parashikimi në buxhet i fondeve specifike për përmirësimin e infrastrukturës së Institucionit;	Senati akademik Bordi i Administrimit Njësitë Kryesore Njësitë Bazë	Burime njerëzore Burime financiare
<i>Përdorimi i platformave digjitale</i>	Përdorimi i platformave si UVMS, Google Classroom për shpërndarjen e materialeve dhe për komunikim më efektiv Trajnimi i stafit akademik dhe studentëve për përdorimin e këtyre platformave	Njësitë bazë IT	Burimet njerëzore

Adresa /Address: Bly. Ismail Qemali/ Pallatet Conad, kati II, Vlorë, Albania, 9400
Tel. Fax 4435533224552

web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

REPUBLICA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
KOMISION AD-HOC



Rritja e aksesit në burime	Sigurimi i literaturës bashkëkohore dhe rritja e mundësive për shkëmbime ndërkombëtare me universitete të tjera Parashikimi në buxhet i fondeve specifike për literaturë bashkëkohore; Përdorim më i lart i pedagogëve dhe studentëve të bibliotekave on-line.	Senati akademik Bordi i Administrimit Njësitë Kryesore Njësitë Bazë	Burime njerëzore Burime financiare
Rritja e orëve praktike	Ndryshimet brenda 20% me qëllim rritjen e orëve të praktikës	Senati Akademik Njësia Kryesore Njësia Bazë Bordi i Administrimit	Burime njerëzore Burime financiare
Zgjerimi i kapaciteteve laboratorike.	Parashikimi në buxhet i fondeve specifike për përmirësimin e infrastrukturës së Institucionit;	Senati akademik Bordi i Administrimit Njësitë Kryesore Njësitë Bazë	Burime njerëzore Burime financiare
Përfshirja në praktikë reale:	Bashkëpunimi me spitale, shkolla dhe operatorë turistikë për përvojë më të gjerë praktike.	Njësitë Kryesore Njësitë Bazë	Burimet njerëzore
Rritja e transparencës	Sigurimi i udhëzimeve të qarta për provimet dhe vlerësimet. Pedagogët duhet të ofrojnë feedback të detajuar dhe në kohë. Në fillim të secilit modul pedagogu i lëndës tu prezantoj syllabusin studentëve Zhvillimi i leksioneve konsultuese në fund të semestrit akademik Parashikimi i pikëve për secilën pyetje në tezën e provimit Parashikimi nga pedagogët i orareve specifike mbi sqarimin e studentëve për rezultatet e provimit	Njësitë Bazë	Burime njerëzore

Adresa /Address: Bllv. Ismail Qemali, Pallatet Conad, kati II, Vlorë, Albania, 9400
Tel. Fax: ++35533224952

web site: www.uovlora.edu.al
e-mail: info@uovlora.edu.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
KOMISION AD-HOC

<i>Vlerësimi i objektiv studentëve</i>	Vlerësimi i studentëve duhet të jetë i drejtë dhe i bazuar në kritere të qarta për të reduktuar pasigurinë. Të bëhen kontrole sporadike nga drejtuesit departamentit	Njësitë bazë	Burimet njerëzore
<i>Trajnimi i stafit:</i>	Trajnime për përdorimin e teknologjive dhe metodologjive të reja mësimore.	Njësitë bazë	Burimet njerëzore
<i>Angazhimi i pedagogëve:</i>	Pedagogët duhet të jenë më të pranishëm për të ndihmuar studentët me udhëzime teknike dhe akademike. Kontrolle të vazhdueshme nga Drejtuesi i Njësisë Kryesore dhe Bazë mbi respektimin e orarit nga pedagogët	Njësitë Kryesore Njësitë Bazë	Burime njerëzore
<i>Rritja e dialogut dhe diskutimeve me studentët</i>	Nxitja e komunikimit të hapur ndërmjet studentëve dhe pedagogëve për çështje komplekse dhe sfida mësimore. Angazhimi i Këshilltarëve akademik në takime të herëpashershme me studentët të të gjitha viteve akademike duke disukutuar nevojat, të drejtat dhe detyrimet e studentëve.	Njësitë kryesore Njësitë bazë	Burimet njerëzore
<i>Angazhimi aktiv i studentëve në leksione, seminare, praktika dhe laboratore:</i>	Inkurajimi nga pedagogët për pjesmarrje aktive të studentëve në leksione; Trajnim i vazhdueshëm i pedagogëve për angazhim më të lart të studentëve gjatë leksioneve.	Senati akademik Bordi i Administrimit Njësitë Kryesore Njësitë Bazë	Burime njerëzore Burime financiare
<i>Përfshirja e studentëve në grupe pune në projekte kërkimore dhe aktivitete të cilat rrisin ndërgjegjësimin e tyre për profesionin</i>	Inkurajim i studentëve për të prezantuar ide inovative të tyre Parashikimi në buxhet i një fondi specifik për financimin e ideve inovative të studentëve; Pjesmarrje më aktive e studentëve në HUB-et ndërtuara në Universitet; Organizimi më i mirë i studentëve në aktivitete të pavarura, podcaste	Senati akademik Bordi i Administrimit Njësitë Kryesore Njësitë Bazë Këshilli I studentëve	Burime njerëzore Burime financiare
<i>Rritje të pjesmarrjes së studentëve në</i>	Informim i studentëve rregullisht mbi plotësimin e pyetësorit;	Njësitë Bazë NJSBC	Burime njerëzore

Adresa /Address: Bll. Ismail Qemali, Pallatet Conad, kati II, Vlorë, Albania, 9400
Tel. Fax: +35533224957

web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al